


PARREGULLSITË NGA
PJESETARËT E STAFIT
AKADEMIK TË UP-SË

RASTET E PROFESORËVE
ME KALLËZIME PENALE,
AKTAKUZA DHE DËNIME

MOSOFRIMI I QASJES NË
INFORMATA SI SHKELJE E
LIRISË SË SHPREHJES

PROFESORËT PËRBALLË LIGJIT



botues:
ADMOVEVERE
(drejtësi transicionale | edukim | paqëndërtim)
<http://admovere.org/>

për botuesin:
Shkëlzen Gashi

ky raport u hartua nga:
Aulonë Memeti

shtojca e raportit u hartua nga:
Rina Kika

recensentë:
Arbër Vokri
Emir Ahmetaj
Flutura Kusari
Xhevahir Kolgjini

redaktor gjuhësor:
Gazmend Bërlajolli

karikatura në kopertinë:
Jeton Mikullovc

dizajni i kopertinës dhe faqesja:
Arbër Racaj

shtypi:
Printingpress

maj 2019
Prishtinë

tirazhi:
300

hulumtimi dhe botimi u përkrahën nga:
KFOS (Kosovo Foundation for Open Society)

ADMOVEVERE është anëtare e Koalicionit për Integritet dhe Transparencë në Universitet – KITU, mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur – KFOS. Ky hulumtim është pjesë e programit të KITU-së. Pikëpamjet e shprehura në këtë hulumtim janë të OJQ-së ADMOVEVERE dhe nuk paraqesin detyrimisht pikëpamjet e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur – KFOS, e as të recensentëve.

ADMOVEVERE (Transitional Justice | Education | Peacebuilding) angazhohet për ndërtimin e një shoqërie demokratike, promovimin e tolerancës e bashkëjetesës dhe luftimin e paragjytimeve; dialogun mes komuniteteve të ndara për t'i tejkuluar mosmarrëveshjet, si dhe promovimin e praktikave të mira për drejtësi dhe pajtim. Fushat kryesore të organizatës janë të drejtat e njeriut, me theks të veçantë te drejtësia transicionale, edukimi dhe ndërtimi i paqes.

Për më shumë: <http://admovere.org/>

PËRMBAJTJA

HYRJA

**I PARREGULLSITË NGA PJESËTARËT
E STAFIT AKADEMIK TË UP-SË**

**II RASTET E PROFESORËVE ME
KALLËZIME PENALE,
AKTAKUZA DHE DËNIME**

PËRFUNDIMET

**SHTOJCË
MOSFRIMI I QASJES NË
INFORMATA SI SHKELJE E
LIRISË SË SHPREHJES**

**■ ■
PËRMBAJTJA**

SHKURTESAT

AKA	Agjencia e Kosovës për Akreditim
BA	Bachelor
BE	Bashkimi European
FIEK	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike
FIM	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike
FNA	Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe i Arkitekturës
FshMN	Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore
KITU	Koalicioni për Integritet dhe Transparencë në Universitet
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KLI	Kosovo Law Institute
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
MA	Master of Arts
MAShT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
OJQ	Organizatë Joqeveritare
ORCA	Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim
PhD	Doctor of Philosophy
RrGK	Rrjeti i Grave të Kosovës
UP	Universiteti i Prishtinës

BAJTIJA

HYRJE

Raporti «Profesorët përballë ligjit» sjell në vëmendjen e publikut mënyrën se si administrohet drejtësia në ato raste kur të dyshuarit, të akuzuarit ose të dënuarit janë pjesëtarë të stafit akademik të Universitetit të Prishtinës (UP), më të madhit universitet publik në vendin tonë. Për këtë qëllim, raporti në thelbin e tij përqendrohet në raste konkrete të shkeljeve të ndryshme të kryera prej pjesëtarëve të këtij stafi, si brenda universitetit, ashtu edhe jashtë tij, për të hetuar nëse ato kanë rezultuar me ndonjë pasojë për angazhimin e tyre akademik.

Vlerësojmë se është tejet me rëndësi që të gjenerojmë debat publik për këtë temë, meqë janë pjesëtarët e stafit akademik të UP-së ata që duhet t'u shërbejnë si model brezave të ardhshëm që i arsimojnë. Veç kësaj, duke qenë shtresë akademike, shumë prej tyre gëzojnë edhe hapësirë mediale, që d.m.th. se me veprimet e tyre vendosin edhe standarde sociale. Për më tej, paguhen me paratë e tatimpaguesve kosovarë, prandaj kanë përgjegjësi jo vetëm ligjore, por edhe morale për veprimet që bëjnë.

Raportin e pjesën e parë paraqet rastet kur pjesëtarët e stafit akademik të UP-së – qofshin profesorë të rregullt, profesorë të asocuar, profesorë asistentë ose asistentë – dyshohen të kenë shkelur në çfarëdo mënyre Kodin e Etikës të UP-së: me mosparaqitje në ligjërata e konsultime; ngacmime seksuale; falsifikime; korrupsione të tilla si keqpërdorime të pozitës zyrtare, avancime jomeritore, nepotizëm, lidhje politike, etj.

Në pjesën e dytë, raporti paraqet raste të përballjeve të pjesëtarëve të stafit akademik të UP-së me ligjin në Kosovë, që kanë rezultuar me kallëzime penale, aktakuza, ose dënime nëpër institucionet e drejtësisë, qoftë edhe për veprime që nuk lidhen me punën e tyre në UP, ndonëse Kodi i Etikës për Stafin Akademik të UP-së përcakton se relevante janë vetëm veprat penale që rezultojnë me dënim nga gjykata dhe që e demonstrojnë qartë papërshtatshmërinë për të vazhduar punën si pjesëtarë të stafit akademik¹.

¹ Kodi i Etikës për Stafin Akademik të UP-së, 19 korrik 2013, gjendet në:
<https://www.uni-pr.edu/desk/inc/media/CFEBCD0D-8BC1-462A-8BF6-6C41152AD4B4.pdf>

Për nevojat e pjesës së parë të raportit u dërguam kërkesë zyrtare për qasje në të dhëna dhe dokumente publike të gjithë dekanëve të fakulteteve të UP-së, Rektorit dhe të gjithë prorektorëve, Sekretarit të Përgjithshëm dhe Këshillit të Etikës të UP-së, Agjencisë Kosovare për Akreditim (AKA), si dhe Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK). Po ashtu, kërkuam intervista me të gjithë dekanët, me rektorin dhe të gjithë prorektorët e UP-së. Takuam edhe përfaqësues të organizatave dhe të institucioneve joqeveritare relevante, që në forma të ndryshme i kanë përcjellë zhvillimet në UP, si: ÇOHU, Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK), Kosovo Law Institute (KLI), Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim (ORCA), e madje edhe gazetarë të mediave të ndryshme që kanë raportuar për zhvillimet në UP.

Për t'i prezentuar rastet e përballjeve me ligjin të pjesëtarëve të stafit akademik të UP-së që nga paslufta, kërkuam dokumentet publike në shtatë gjykatat themelore të Kosovës, në Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Gjilan dhe Gjakovë. Kontaktoam edhe Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK) si dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK).

Më pas, përmblodhëm të gjitha ato raste të përballjeve me ligjin të stafit akademik të UP-së, të cilat gjatë kësaj dekade janë publikuar nëpër media (gazeta, radio, televizione dhe portale). Nëpër raportimet mediatike të rasteve shqyrtuam çështje të tilla si: për ç'arsye janë përballur me ligjin pjesëtarët e stafit akademik të UP-së; sa prej tyre janë hetuar, sa janë akuzuar, sa janë dënuar dhe sa janë liruar nga gjykatat; në sa raste ka marrë vendim prokuroria për pushim ose ndërprerje të hetimeve; sa raste janë në proces të shqyrtimit; sa janë parashkruar; çfarë masash ka ndërmarrë UP-ja kur institucionet e drejtësisë kanë konstatuar shkelje ligjore nga ana e pjesëtarëve të stafit akademik të saj?

Kufizimin kryesor metodologjik në këtë raport është hezitimi dhe mospërgjigjja e shumë prej institucioneve dhe organeve relevante universitare e gjyqësore, çka na pamundësoi intervistimin e zyrtarëve dhe titullarëve të caktuar, si dhe qasjen në dokumentet publike. Meqë raporti merr parasysh edhe ndërlikimet ligjore të paraqitjes së të dhënave të tilla, e ndër to edhe të drejtën e prezumimit të pafajësisë për pjesëtarët e stafit akademik të UP-së që kanë lëndë të hapura, të përmbyllura, ose tashmë të vjetruara, në gjykata ose në institucione të tjera të drejtësisë, hartuam një analizë ligjore që shtjellon argumente për ndikimin e hezitimit dhe mospërgjigjes së institucioneve përkatëse ndaj kërkesave tona zyrtare.

1.

SHKELJET NGA PJESËTARËT E STAFIT AKADEMIK TË UP-SË

Qëllimi i parë i këtij raporti është me i paraqitë rastet kur pjesëtarë të stafit akademik të UP-së - profesorë të rregullt, profesorë të asocuar, profesorë asistentë dhe asistentë – dyshohen të kenë kryer shkelje të Kodit të Etikës të UP-së, si: avancime jomeritore akademike, mungesë të ndershmërisë akademike, mosparaqitje në ligjërata e konsultime, ngacmime seksuale, e me radhë. Meqenëse për çështjen në fjalë nuk morëm përgjigje nga Këshilli i Etikës, po u referohemi hulumtimeve dhe raportimeve të ndryshme nga organizata të shoqërisë civile.

Sautakon **avancimeve akademike**, Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim (ORCA), pati raportuar se gati gjysma e drejtuesve të UP-së, përfshirë anëtarët e Këshillit Drejtues, rektorin dhe prorektorët, anëtarët e Senatit, dekanët dhe prodekanët, nuk i justifikonin titujt akademikë². Këta pjesëtarë të stafit akademik kishin të paktën nga një punim nëpër revista të listuara si të dyshimta ose në publikime që s'i përmbushnin kriteret e revistave të mirëfillta shkencore³. Hulumtimi nga e njëjta organizatë i bërë me CV-të e profesorëve të UP-së nxori rezultate edhe më të këqija sesa të mësipërmet⁴. Statuti i UP-së dhe Rregullorja për përzgjedhjen dhe avancimin e personelit akademik parashohin kushtet e lehta lidhur me avancimet akademike: «punim në revistë shkencore relevante ndër kombëtare apo rajonale si autor i parë ose korrespondent». Rregullat përcaktojnë se profesori asistent duhet të ketë të paktën një, profesori i asocuar të paktën tri, ndërsa profesori i rregullt pesë punime të tilla⁵.

2 Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim (ORCA) «Integriteti Akademik i Drejtuesve të Universitetit të Prishtinës», Prishtinë, 2017, gjendet në: http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2017/02/ORCA-_Raporti-Komplet_Print.pdf

3 Po aty.

4 Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim (ORCA) «Integriteti Akademik i Profesorëve të Universitetit të Prishtinës», Prishtinë, 2017, gjendet në: <http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2017/12/Integriteti-akademik-i-profesoreve-ne-Universitetin-e-Prishtines.pdf>

5 Statuti i Universitetit të Prishtinës, gjendet në: <https://www.uni-pr.edu/inc/doc/statuti1.pdf>; Rregullorja për Përzgjedhjen dhe Avancimin e Personelit Akademik.

Një tjetër aspekt i lidhur me mungesën e kualifikimeve të stafit akademik të UP-së është **plagjiatura** në mesin e këtij stafi. Ka indikacione që plagjiatura është e përhapur si ndërmjet stafit akademik, ashtu edhe te studentët në UP. Shumë shpesh, punimet e diplomave janë plagjiatura të punimeve të viteve të mëparshme, e ka edhe raste kur, siç raportonte organizata ÇOHU, shkruhen kundrejt një pagese të caktuar nga individë që ofrojnë këso shërbimesh përmes rrjeteve sociale dhe shpalljeve që afishohen madje edhe nëpër hapësirat e UP-së⁶. Edhe kur punimet plagjiatë zbulohen, dorëheqjet jonetëm nuk jepen, por nuk ndërmerren as masat për veprimet të tilla nga organet kompetente. Vitin e kaluar ADMOVERE publikoi 16 rastet e plagjiaturave të pjesëtarëve të stafit akademik të UP-së, për të cilat ishte raportuar në media përgjatë viteve⁷.

Veç këtyre, shumë profesorë të UP-së mbajnë poste publike e qeveritare dhe janë të punësuar në institucione të ndryshme, prandaj në vend të tyre **ligjëratat dhe provimet** në UP ua mbajnë asistentët⁸. ORCA pati monitoruar mbajtjen e konsultimeve sipas orareve zyrtare në tri fakultete të UP-së me numrin më të madh të studentëve: Fakultetin Filozofik, Ekonomik dhe Juridik. Nga ky monitorim rezultonte se shumë profesorë mungonin në konsultimet që duhej t'i mbanin gjatë orarit të punës. Sipas të gjeturave të ORCA-s, nga 1177 ligjërata të monitoruara gjithsej në Fakultetin Ekonomik, Filozofik dhe Juridik, 218 apo 18,5% prej tyre nuk janë mbajtur për shkak të mungesës së profesorëve⁹. Megjithatë, nuk ka shqiptim të masave e as ndalesa financiare për profesorët që nuk mbajnë ligjëratat dhe provimet, siç parashihet në Rregulloren për Masat Disiplinore ndaj Personelit Akademik të UP-së¹⁰.

6 ÇOHU «Pazari me Tema të Diplomës», Prishtinë, 2018, gjendet në: <http://preportr.cohu.org/sq/hulumtime/Pazari-me-tema-te-diplomes-224>

7 ADMOVERE «Stafi Akademik i UP-së – studimet, angazhimet tjera, plagjiaturat, vlerësimet dhe përpjesa staf studentë», Prishtinë, 2018, gjendet në: http://admovere.org/wp-content/uploads/2018/11/admovere_plagjiaturaUP_ALB_web-2.pdf.

8 Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim (ORCA) «Dembelët e Hasan Prishtinës I», Prishtinë, 2017, gjendet në: http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2017/05/Raporti-i-Monitorimit_Interactive.pdf; dhe Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim (ORCA) «Dembelët e Hasan Prishtinës II», Prishtinë, 2017, gjendet në: http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2017/07/Dembelet-e-H.P.2_Final_Shqip.pdf.

9 Po aty.

10 Po aty.

Çështja më shqetësuese është **ngacmimi seksual**. Sipas një publikimi nga Qendra për Art dhe Komunitet «Artpolis», i cili vë theksin në masë të madhe te UP-ja si universiteti më i madh publik në vend, ngacmimi seksual është i përhapur, por nuk raportohet pothuajse fare. Kur ndonjë rast raportohet, nuk ndërmerret asgjë. Sipas publikimit në fjalë, studentet nuk i raportojnë rastet e ngacmimit seksual mbasi, përveçse nuk besojnë se do të ndërmerren masa, kanë frikë nga pasojat e mundshme, por edhe nga turpërimi publik¹¹. UP-ja ka përcaktuar një grup rregullash në Kodin e Etikës për Personelin Akademik, që parashohin edhe trajtimin e rasteve të ngacmimit seksual, por ende nuk ka politika të hartuara specifikisht që t'i inkurajojnë studentët t'i raportojnë rastet e tilla, e as përcaktim të procedurave që duhen ndjekur nga stafi akademik dhe administrativ pasi të raportohen rastet dhe të fillojnë procedurat.

ADMOVERE u dërgoi kërkesë për intervistë rreth çështjeve të mësipërme dekanëve të të gjitha fakulteteve, Rektoratit (rektorit dhe prorektorëve), Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe Këshillit të Etikës të UP-së. Kërkonim të mësonim prej tyre sa prej pjesëtarëve të stafit akademik të secilit prej fakulteteve të UP-së kanë kryer njërën nga këto shkelje: avancime jomeritore akademike, mosparaqitje në ligjërata dhe konsultime, keqpërdorim të pozitës zyrtare, ngacmime seksuale, ose çfarëdo shkelje tjetër.

Pesë prej dekanëve nuk iu përgjigjën kërkesës për intervistë, as përmes e-mail-it e as përmes telefonit. Këta janë Lindita Sejdiu-Rugova nga Fakulteti i Filologjisë, Ethem Çeku nga Fakulteti i Edukimit, Enver Hamiti nga Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Musa Selimi nga Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit, si dhe Haxhi Gashi nga Fakulteti Juridik. Katër prej dekanëve, konkretisht But Dedaj nga Fakulteti Ekonomik, Bujar Dugolli nga Fakulteti Filozofik, Tahir Arbnesi nga Fakultetit i Shkencave

¹¹ Qendra për Art dhe Komunitet - Artpolis «Trajtimi i Ngacmimit Seksual në Universitete Publike», Prishtinë, 2017.

Matematiko-Natyrrore, si dhe Agim Selimi nga Fakulteti i Arteve, na thanë se Kolegjiumi i Dekanëve ka marrë vendim që dekanët nuk kanë të drejtë t'u përgjigjen pyetjeve tona dhe se përgjigjet mund t'i marrim nga Sekretari i Përgjithshëm i UP-së. Nga ana tjetër, Dekani Abdullah Zejnullahu nga Fakulteti i Arkitekturës dhe i Ndërtimtarisë na ka pritur në takim dhe na ka njoftuar se nuk posedon të dhëna zyrtare për shkeljet në fjalë. Prodekanja Gloria Staka, në emër të Dekanes Suzana Manxhuka-Kërliu nga Fakulteti i Mjekësisë, ka thënë se do të na përgjigjet gjatë ditëve në vijim, por nuk na ka nisur asnjë përgjigje deri në publikimin e këtij raporti.

Vetëm dy dekanë, Skënder Kaçiu nga Fakulteti i Bujqësisë dhe i Veterinarisë¹² dhe Ahmet Shala nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike¹³, pranuan të zhvillonin intervista. Të pyetur sa pjesëtarë të stafit akademik të fakultetit që e drejtojnë kanë kryer njërën nga shkeljet e mësipërperme, të dy u shprehën se nuk kanë asnjë rast të dokumentuar.

Përveç këtyre, askush nga Rektorati, pra as rektori e as prorektorët nuk iu përgjigjën pyetjeve që ua dërguam për të kuptuar më shumë rreth rasteve kur pjesëtarët e stafit akademik kanë kryer shkelje të Statutit, të Kodit të Etikës ose të rregulloreve të tjera të UP-së. Njëloj, as Sekretari i Përgjithshëm i UP-së, i cili sipas nenit 233 të Statutit të UP-së është përgjegjës për dhënien e të drejtës për qasje në një bazë specifike të dhënave, nuk iu përgjigj pyetjeve që ia parashtruam. Së fundi, dorëzuar në Këshillin e Etikës të UP-së kërkesë zyrtare për informata mbi shkeljet e Kodit të Etikës nga ana e pjesëtarëve të stafit të rregullt akademik. Këshilli i Etikës është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Kodit të Etikës dhe për zhvillimin e procedurave disiplinore, mirëpo nuk morëm përgjigje as prej zyrtarëve të tij.

¹² Intervistë me Dekanin e Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë, Skënder Kaçiu, 7 maj 2019, Prishtinë.

¹³ Intervistë me Dekanin e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, Ahmet Shala, 6 maj 2019, Prishtinë.

2

RASTET E PROFESORËVE ME KALLËZIME PENALE, AKTAKUZA DHE DËNIME

Raporti ka për qëllim të gjenerojë debat publik rreth administrimit të rasteve kur të dyshuarit, të akuzuarit e të dënuarit janë pjesëtarë të stafit akademik të UP-së. Për këtë, kërkuam informata lidhur me kallëzimet penale, aktakuzat dhe aktgjykimet në shtatë gjykatat themelore të Kosovës – Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Gjilan dhe Gjakovë, si dhe në Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK) e në Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK).

Kufizimi kryesor për ta realizuar këtë pjesë të hulumtimit u diktua nga hezitimi dhe mospërgjigjja e disa prej institucioneve ndaj kërkesave tona për qasje në dokumentet publike. Tri nga shtatë gjykatat themelore – ajo në Pejë, në Prizren e në Gjakovë – na u përgjigjën se nuk ka pjesëtarë të stafit akademik të UP-së që të kenë pasë lëndë në gjykatat e tyre, ndërkaq gjykatat në Ferizaj, Mitrovicë dhe Prishtinë ndonëse u shprehën të gatshme të na ndihmonin, nuk iu përgjigjën kërkesave tona konkrete. Mospërgjigjja e Gjykatës Themelore në Prishtinë na e afektoi më së rëndi raportin, duke qenë se dëshmitë për shkeljet e ligjit nga profesorët e UP-së gjenden kryesisht në këtë gjykatë. Duhet potencuar se, për këto mospërgjigje parashtruam gjashtë ankesa te Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP). IAP na njoftoi se ankesat tona janë të pranueshme dhe se shkeljet eventuale do të hetohen nga ky institucion. Po kështu, as KGJK e as KPK nuk iu përgjigjën kërkesave për të na siguruar qasje në kallëzimet penale, aktakuzat dhe aktgjykimet. Duhet theksuar se Gjykata Themelore në Gjilan iu përgjigj kërkesës sonë dhe ishte tejet bashkëpunuese, për çka i jemi shumë mirënjohës.

Në vazhdim të këtij kapitulli i prezentojmë përmbledhtazi në renditje kronologjike rastet e kallëzimeve penale, aktakuzave, dënimeve të ndryshme të pjesëtarëve të stafit të rregullt të UP-së, të publikuara ndër vite nëpër media të ndryshme.

Mohim i përgjegjësisë: asnjë nga pjesëtarët e stafit akademik të përmendur në këtë kapitull nuk janë shpallur fajtorë me aktgjykim të formës së prerë për veprat penale të cilat u janë vënë barrë. Prandaj, të gjithë pjesëtarët e stafit akademik të radhitur këtu konsiderohen të pafajshëm sipas nenit 3 të KPPK.

Valton Beqiri profesor i rregullt në Fakultetin e Arteve të UP-së

Në prill 2012 Prokuroria Themelore në Prishtinë ngriti aktakuzë për keqpërdorimin e detyrës zyrtare kundrejt dy ish-ministrave të Kulturës të Republikës së Kosovës, Valton Beqirit (2008-2010) dhe Astrit Haraqisë (2004-2007). Të dy kishin nënshkruar kontrata në vlerë totale prej 570.000 eurosh, që sipas aktakuzës, binte ndesh me Ligjin për Prokurimin Publik dhe Ligjin për Kinematografinë¹⁴. Sipas aktakuzës, Valton Beqiri, gjatë kohës sa ishte Ministër i Kulturës, kishte nënshkruar aneks-kontratën me kompaninë «Morina Films», duke ia transferuar subvencionin prej 100.000 eurosh për realizimin e filmit «Mysafir në Sofër»¹⁵. Pararendësi i tij, Astrit Haraqija, kishte nënshkruar një kontratë në vlerë prej 220.000 eurosh me Nehat Fejzën, pronar i kompanisë «Concordia Pictures», dhe një kontratë tjetër me Armond Morinën, pronar i kompanisë «Morina Films», në vlerë prej 350.000 eurosh.

Në dhjetor 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë shpalli aktgjykim dënues ndaj Valton Beqirit dhe Astrit Haraqisë¹⁶. Të dy u dënuan me nga një vit burg me kusht, me urdhëresën që dënimi të mos ekzekutohej nëse nuk do të kryenin tjetër vepër penale gjatë dy vjetëve të ardhshëm. Të akuzuarit ushtruan ankesë ndaj aktgjykimit dënues në Gjykatën e Apelit, e cila e ktheu çështjen te Gjykata Themelore për rivendosje për shkak të shkeljes esenciale të procedurës penale¹⁷. Gjykata Themelore sërish shpalli aktgjykim dënues, ndërsa të akuzuarit sërish paraqitën ankesë në Gjykatën e Apelit. Në prill 2017, Gjykata e Apelit e liroi Valton Beqirin nga akuzat për «keqpërdorim të detyrës apo të autoritetit zyrtar», meqë «gjykata e shkallës së parë nuk kishte dhënë fakte vendimtare për veprimet inkriminuese të të akuzuarit, lidhur me dashjen si element subjektiv të veprës penale». Edhe Astrit Haraqija u lirua¹⁸.

Në lidhje me këtë rast, kërkua një prononcim nga profesor Valton Beqiri, por deri në publikimin e këtij raporti, nuk morëm kurrfarë përgjigje prej tij.

14 Skender Govori «Ankesë për rastin e ish-Ministrave të Kulturës», Kallxo, 1 prill 2016, gjendet në: <https://kallxo.com/prokuroria-ankese-per-rastin-e-ish-ministrave-te-kultures/>

15 Skender Govori «Gjykata e Apelit e liron ish-Ministrin e Kulturës Valton Beqiri», Betimi për Drejtësi, 2 qershor 2016, gjendet në: <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-e-apelit-e-liron-ish-ministrin-e-kultures-valton-beqiri/>

16 Po aty.

17 Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale paraqet bazë për kontestimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë me ankesë sipas nenit 393 dhe 384 të KPPK. Për shembull, shkelje esenciale të procedurës penale paraqet rasti kur në vendosjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari që nuk ka qenë i pranishëm në shqyrtim gjyqësor ose gjyqtari që është dashur të përjashtohet nga shqyrtimi gjyqësor; rasti kur publiku është përjashtuar nga shqyrtimi gjyqësor në kundërshtim me ligjin; rasti kur aktgjykimi bazohet në provë të papranueshme, etj. Gjatë shqyrtimit të ankesës, Gjykata e Apelit shqyrton çdo herë sipas detyrës zyrtare nëse gjatë marrjes së vendimit të shkallës së parë ka pasur shkelje esenciale të procedurës penale sipas nenit 393, paragrafi 1 KPPK.

18 Po aty.

Esat Belaj Gazmend Maliqaj dhe Rajan Zeneli,

asistentë në Fakultetin e Mjekësisë të UP-së

Më 5 dhjetor 2014 Departamenti për Krime të Rënda i Prokurorisë Themelore në Prishtinë ngriti aktakuzë ndaj 13 personave, asistentë e studentë senatorë nga Universiteti i Prishtinës, për shkak të dyshimit se kishin kryer veprat penale: ushtrim ndikimi, dhënie e marrje rryshfeti dhe keqpërdorim të detyrës zyrtare¹⁹. Të akuzuarit ishin Esat Belaj, Rajan Zeneli, Kemajl Gashi, Arian Janova, Leonard Bytyqi, Kushtrim Morina, Mevlyn Beqiri, Gazmend Maliqaj, Arton Hoti, Albion Haxhijaha, Muhamed Maliqi, Shaqir Reqica dhe Amonda Orllati²⁰. Sipas Prokurorisë, qëngaviti 2009 deri në vitin 2012 të akuzuarit kishin marrë rryshfete për favore të ndryshme si regjistrimi i jashtëligjshëm i studentëve pa provim pranues në Fakultetin e Mjekësisë dhe kryerja e provimeve të tyre²¹. Askush nga Dekanati i Fakultetit të Mjekësisë e as nga Rektorati i UP-së nuk u përfshi në këtë aktakuzë.

Më 6 korrik 2017, gati tre vjet pas ngritjes së aktakuzës, 12 nga 13 të akuzuarit u dënuan nga Gjykata Themelore në Prishtinë për marrje e dhënie rryshfeti, ushtrim ndikimi dhe keqpërdorim të pozitës ose të autoritetit zyrtar²². Akuza për ndihmesë në ushtrim ndikimi ndaj asistentit Rajan Zeneli ishte parashkruar²³, prandaj u refuzua nga Gjykata Themelore²⁴. Dënimet e shqiptuara ndaj 12 të akuzuarve të tjerë ishin nga 3 deri në 32 muaj burgim, kurse gjjobat e shqiptuara arrinin shuma deri në 10.000 euro²⁵.

Të dënuarit parashtruan ankesa në Gjykatën e Apelit, e cila më 27 tetor 2017 i aprovoi ato si të bazuara dhe i liron nga akuza që të gjithë, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale²⁶.

Për rastin në fjalë kërkuam prononcim nga Dekanati i Mjekësisë, por nuk morëm përgjigje.

19 «Prokuroria Godet Fakultetin e Mjekësisë, aktakuzë ndaj 13 personave», KALLXO.com, 5 dhjetor 2014, gjendet në: <https://kallxo.com/prokuroria-godet-fakultetin-e-mjekesise-aktakuze-ndaj-13-personave/>

20 «Shtyhet seanca gjyqësore ndaj 13 të akuzuarve për korrupsion në UP», Betimi për Drejtësi, 9 shkurt 2016, gjendet në: <https://betimiperdrejttesi.com/shtyhet-seanca-gjyqesore-ndaj-13-te-akuzuarve-per-korrupsion-ne-up/>; «Nga seanca ku u dënuan 12 personat e përfshirë në skandalin me regjistrime në UP», KOHA.net, 6 korrik 2017, gjendet në: <https://www.koha.net/video/29962/nga-seanca-ku-u-denuan-12-personat-e-perfshire-ne-skandalin-me-regjistrime-ne-up/>

21 Po aty.

22 «12 asistentë e studentë të UP-së dënohen me burg e gjjoba për rryshfet», KOHA.net, 6 korrik 2017, gjendet në: www.koha.net/kronike/29829/12-asistente-e-studente-te-up-se-denohen-me-burg-e-gjjoba-per-ryshfet

23 Parashkrimi i ndjekjes penale paraqitet kur kalon afati i caktuar me ligj brenda të cilit prokurori i shtetit mund ta ndjekë penalisht personin e dyshuar për kryerjen e veprës penale. Pas kalimit të afatit ligjor të parashkrimit, prokurori i shtetit nuk mund të vazhdojë ndjekjen penale (nenet 99-104 KPPK). Për shembull, veprat penale që dënohen me deri në 1 vit burgim mund të ndiqen penalisht brenda afatit 4-vjeçar nga dita e kryerjes së veprës penale (neni 101, paragrafi 1, pika 6 KPPK). Afati i parashkrimit nuk zbatohet për veprën penale vrasje e rëndë, veprat penale të gjenocidit, krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit, ose veprave të tjera që sipas të drejtës ndërkombëtare nuk parashkruhen (neni 104 KPPK).

24 Po aty.

25 Po aty.

26 «Apeli i liron nga akuza 12 studentët dhe asistentët e UP-së», Betimi për Drejtësi, 21 nëntor 2017, gjendet në: <https://betimiperdrejttesi.com/apeli-i-liron-nga-akuzat-12-studentet-dhe-asistentet-e-up-se/>



RASTET

RASTI 1

Enver Hasani profesor i rregullt i Fakultetit të Juridikut

Më 31 korrik 2015 Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) ngri aktakuzë në Gjykatën Themelore të Prishtinës për veprën penale mashtrim në detyrë në bashkëkryerje kundër ish-rektorit të UP-së, Enver Hasanit, ish-shefit të zyrës së prokurimit në UP, Hakif Veliut, si dhe drejtorit të Institutit për Studime Ndërkombëtare (ISN) në Tiranë, Albert Ragipit²⁷. Sipas aktakuzës, të akuzuarit kishin falsifikuar kontratën origjinale «Përkthimi i librave nga gjuha angleze në gjuhën shqipe, për nevojat e Universitetit të Prishtinës», me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për ISN-në²⁸. Në Aktakuzë thuhej se neni 17 i kontratës në fjalë ishte ndryshuar. Çmimi origjinal kishte qenë 12.65 euro për 1000 fjalë, mirëpo Enver Hasani dhe të akuzuarit e tjerë e kishin ndryshuar në 12.65 euro për 1000 karaktere, që e frynte çmimin fillestar në 60 euro për 1000 mijë fjalë²⁹. Ky ndryshim i njësisë matëse nga ‘fjalë’ në ‘karakterë’ thuhej se i kishte mundësuar ISN-së përfitim të kundërligjshëm në shumë prej 70.426,90 EUR³⁰.

Më 18 tetor 2017, Enver Hasani dhe dy të akuzuarit e tjerë u shpallën fajtorë nga Gjykata Themelore në Prishtinë për kryerjen e veprës penale mashtrim në detyrë të Kodit Penal të Kosovës³¹. Enver Hasani iu shqiptua dënimi një vit burg me kusht, kurse Albert Rakipit dhe Hakif Veliut me nga gjashtë muaj burg, masë kjo e cila u zëvendësua me nga 10.000 euro gjobë. Po ashtu, Gjykata Themelore obligoi Enver Hasanin dhe të akuzuarit e tjerë që dëmin në vlerë prej 70.131 eurosh t’ia kompensojnë UP-së ‘në mënyrë solidare’³².

27 Aktakuzë PPS nr.145/2014, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, Departamenti i Krimeve të Rënda për Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, 31 korrik 2015, Prishtinë.

28 Po aty.

29 Po aty.

30 Po aty.

31 Aktgjykim PAKR. nr. 432/15, Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, 4 dhjetor 2017, Prishtinë.

32 Po aty.

Më 17 maj 2018 Gjykata e Apelit mori vendim për aprovimin e ankesës së Enver Hasanit dhe e liroi atë nga akuza, mirëpo e vërtetoi aktgjykimin dënues për dy të akuzuarit e tjerë dhe ua ashpërsoi dënimin nga 6 muaj në 1 vit burgim, duke vepruar sipas ankesës së Prokurorisë³³. Në Aktgjykim thuhej se nuk ishte provuar që Enver Hasani të kishte kryer veprën penale mashtrim në detyrë sa ishte rektor i Universitetit të Prishtinës dhe se Gjykata Themelore kishte bërë vlerësim të gabuar të gjendjes faktike³⁴. Gjykata e Apelit vlerësoi edhe se nuk ishte vërtetuar që Enver Hasani të kishte pasur marrëveshje paraprake me të akuzuarit e tjerë me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme për ISN-në³⁵.

Pas aktgjykimit lirues të Gjykatës së Apelit, Enver Hasani reagoi nëpërmjet një letre drejtuar senatorëve dhe Këshillit Drejtues të UP-së, në të cilën pretendonte se ky ishte një rast i porositur dhe implikonte Rektorin e UP-së, Marjan Dema³⁶. Madje, më 19 shtator 2018 Hasani ngriti kallëzim penal ndaj rektorit Dema, pos tjerash edhe për veprën penale të deklarimit të rremë nën betim³⁷.

Prokuroria e Shtetit parashtrroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës për pjesën e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit me të cilën lirohej Enver Hasani³⁸. Edhe mbrojtësit e dy të dënuarve nga Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit e kontestuan aktgjykimin dënues para Gjykatës Supreme, duke paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë³⁹. Gjykata Supreme më 2 nëntor 2018 shpalli aktgjykim me të cilin e refuzoi si të pabazuar kërkesën e Prokurorisë së Shtetit ndaj pjesës liruese të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit si dhe e aprovoi si të bazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë së dy të dënuarve, dhe e ktheu rastin në Gjykatën e Apelit për rivendosje⁴⁰. Gjykata e Apelit e liroi nga akuza Enver Hasanin, ndërsa ashpërsoi dënimin për dy të akuzuarit e tjerë, Albert Rakipi e Hakif Veliu, duke ua rritur atë në nga 1 vit burgim efektiv⁴¹.

33 Aktgjykimi PAKR. nr. 27/2018, Gjykata e Apelit, Departamenti i Krimeve të Rënda, 17 maj 2018, Prishtinë.

34 Po aty.

35 Po aty.

36 «U persekutova për faj të Rektorit Marjan Dema – thotë pas lirimit nga akuza Enver Hasani», Klan Kosova, 16 maj 2018, gjendet në: <https://klankosova.tv/u-persekutova-per-faj-te-rektorit-marjan-dema-thote-pas-lirimit-nga-akuza-enver-hasani/>

37 «Enver Hasani ngre Kallëzim Penal ndaj Rektorit të UP-së Marjan Dema», KOHA.net, 20 shtator 2018, gjendet në: www.koha.net/arberi/118229/enver-hasani-ngre-kallezim-penal-ndaj-rektorit-te-up-se-marjan-dema.

38 Aktgjykimi PML. nr. 238/2018, Gjykata Supreme e Kosovës, 2 nëntor 2018.

39 Po aty.

40 Po aty.

41 Labinot Leposhtica «I dënuari për mashtrim në detyrë në kontratën e UP-së shkon në vuajtje të dënimi», 15 tetor 2018, gjendet në: <https://kallxo.com/i-denuari-per-mashtrim-ne-detyre-ne-kontraten-e-up-se-shkon-ne-vuajtje-te-denimit/>

RASTI 2

Më 13 janar 2016 Prokuroria Speciale e Kosovës ngriti aktakuzë kundër Enver Hasanit, në cilësinë e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, për veprat penale falsifikim i dokumentit zyrtar dhe keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar⁴². Sipas Prokurorisë Speciale, Enver Hasani kishte shfrytëzuar kundërligjshëm pozitën dhe autorizimin zyrtar me rastin e marrjes së vendimit ndaj kërkesës së Presidentes së Republikës së Kosovës për dekretin e emërimit të tre gjyqtarëve ndërkombëtarë në Gjykatën Kushtetuese⁴³. Sipas Prokurorisë, Aktvendimi për Papranueshmëri të kërkesës së Presidentes u kishte siguruar mandate shtesë gjyqtarëve ndërkombëtarë, të cilët kishin përfituar prej tij në mënyrë të kundërligjshme⁴⁴. Sipas Aktakuzës, Enver Hasani përveç kësaj kishte shënuar të dhëna të paqena në Aktvendimin për Papranueshmëri, pasi e kishte shënuar si pjesëmarrës në trajtimin e kërkesës emrin e një gjyqtari që nuk kishte marrë pjesë fare në procesin vendimmarrës⁴⁵. Më 8 shtator 2016 është mbajtur një seancë e shqyrtimit gjyqësor për këtë rast, në të cilën Hasani është shpallë i pafajshëm⁴⁶. Në janar 2017, Gjykata e Apelit ka marrë aktvendim për hedhjen poshtë të aktakuzës me arsyetimin se të gjitha veprimet e ndërmarra nga Enver Hasani ishin në kuadër të autorizimeve si Kryetar i Gjykatës Kushtetuese dhe se veprimet inkriminuese për të cilat ai akuzohej nuk përbënin vepër penale⁴⁷. Këtë Aktvendim e vërtetoi edhe Gjykata Supreme, e cila e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruar nga Prokuroria kundër Aktvendimit të Apelit⁴⁸.

ADMOVEERE kërkoi prononcim nga profesor Enver Hasani, i cili nuk pranoi ta komentonte asnjërin nga rastet e paraqitura më sipër, duke ofruar vetëm komente jorelevante për raportin tonë.

42 «Ngrihet aktakuzë kundër Enver Hasanit», Radio Evropa e Lirë, 13 janar 2016, gjendet në: <https://www.evropaelire.org/a/27485751.html>;

43 Po aty

44 Po aty

45 Po aty.

46 «Spektaklet dhe dështimet e aktakuzave dhe gjykimeve për korrupsion gjatë vitit 2017», Betimi për Drejtësi, 6 janar 2018, gjendet në: <https://betimiperdrejtesi.com/spektaklet-dhe-deshtimet-e-aktakuzave-dhe-gjykimeve-per-korrupsion-gjate-vi-tit-2017/>

47 Po aty.

48 Po aty

FAKULTETI I SHKENCAVE

Ferdije Zhushi, profesoreshë e asocuar në Fakultetin e Shkencave
Matematiko-Natyrore

Më 25 nëntor 2014, me kërkesë të PSRK-së dhe urdhëresë të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Policia e Kosovës kreu një operacion në zyrat e AKA-s në Prishtinë, me ç'rast arrestoi Ferdije Zhushi-Etemin dhe Armend Mujën, si dhe bastisi shtëpitë e tyre⁴⁹. Në komunikatën e Prokurorisë Speciale, të lëshuar menjëherë pas arrestimit, thuhej: «përtë pandehurit ekziston dyshimi i arsyeshëm se kanë keqpërdorur pozitën e tyre zyrtare, duke shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin zyrtar, me qëllim që të përfitojnë dobi në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, duke kërkuar përfitime në të holla nga disa pronarë të universiteteve private»⁵⁰. Gjykata vendosi masën e sigurisë që Ferdije Zhushi-Etemi dhe Armend Muja të paraqiteshin në stacionin e policisë një herë në javë gjatë periudhës 30-ditëshe⁵¹.

Më 31 gusht 2015, PSRK ngriti aktakuzë kundër të pandehurve Basri Muja, Ferdije Zhushi-Etemi, Armend Muja dhe Naim Braha. Në shtator 2015 Ferdije Zhushi-Etemi dha dorëheqje nga pozita e Kryetares së Bordit të AKA-s. Në seancën e mbajtur në nëntor 2015, të gjithë të akuzuarit e kundërshtuan aktakuzën⁵². Në procesin gjyqësor Basri Muja dhe Ferdije Zhushi-Etemi ngarkoheshin për keqpërdorimin e pozitës apo të autoritetit zyrtar në bashkëkryerje, si dhe për marrje të ryshfetit, Armend Muja akuzohej për marrje të ryshfetit në vazhdim dhe bashkëkryerje, kurse Naim Braha ngarkohej për dhënie të ryshfetit, por lënda e tij u vjetërsua. Zhushi-Etemi e cilësoi aktakuzën ndaj saj si «hakmarrje dhe shantazh për mosakreditim të kolegjeve ISPE dhe Universum»⁵³.

49 Kreshnik Gashi e Mimoza Kqiku «Arrestohen Ferdije Zhushi-Etemi dhe Armend Muja», Kallxo, 25 nëntor 2014, gjendet në: <http://kallxo.com/arrestohen-ferdije-zhushi-etemi-dhe-armend-muja/>

50 Po aty.

51 Labinot Leposhtica e Armend Zenelaj «Gjyqtarja Vendosi Masën e Sigurisë Ndaj Ferdije Zhushi-Etemit dhe Armend Mujës», Kallxo, 26 nëntor 2014, gjendet në: <https://kallxo.com/gjnk/gjyqtarja-vendosi-masen-e-sigurise-ndaj-ferdije-zhushi-etemit-dhe-armend-mujes-1/>

52 Armend Zenelaj «Ferdije Zhushi dhe të Tjerët Deklarohen të Pafajshëm», Kallxo, 12 nëntor 2015, gjendet në: <https://kallxo.com/arrestohen-ferdije-zhushi-etemi-dhe-armend-muja/>

53 Blerta Ibërdemaj «Zhushi: Aktakuza e ngritur ndaj meje është hakmarrje për mosakreditim të programeve», Kallxo, 9 tetor 2018, gjendet në: <https://kallxo.com/zhushi-aktakuza-e-ngritur-ndaj-meje-eshte-hakmarrje-per-mosakreditim-te-programeve/>

Në janar 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë, lidhur me akuzën për keqpërdorim të detyrës zyrtare në bashkëkryerje, në mungesë të provave e shpalli Ferdije Zhushi-Etemin të pafajshme. Ndërsa për pikat e aktakuzës me të cilat prokuroria e ngarkonte me veprat penale të shpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar sidhepërmarrjetë rryshfetit në bashkëkryerje, Gjykata shpalli aktgjykim refuzues pasi që ishte bërë parashkrimi absolut⁵⁴⁵⁵. E njëjta ndodhi edhe me Basri Mujën. I akuzuari Armend Muja u lirua meqë vepra penale për të cilën akuzohej u vjetërsua⁵⁶. Lidhur me këtë rast, kërkuam një prononcim nga profesoresha Ferdije Zhushi-Etemi, por nuk morëm kurrfarë përgjigje.

54 Blerita Ibërdemaj «Gjykata vendosi për ish-zyrtarët e Agjencisë së Akreditimit», Kallxo, 29 janar 2019, gjendet në: <https://kallxo.com/gjykata-vendosi-per-ish-zyrtaret-e-agjencise-se-akreditimit/>

55 Parashkrimi absolut i ndjekjes penale paraqitet në çdo rast kur kalon dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (neni 100, paragrafi 8 KPPK). Afati i parashkrimit mund të ndërpritet me veprime procedurale të cilat ndërmerren për qëllim të ndjekjes penale të veprës penale (neni 100, paragrafi 5 KPPK). Mirëpo, me paraqitjen e parashkrimit absolut të ndjekjes penale, ndalohet ndjekja penale pavarësisht ndërprerjeve të afatit të parashkrimit që mund të kenë ndodhur gjatë zhvillimit të procedurës penale (neni 100, paragrafi 8 KPPK).

56 <https://telegrafi.com/gjykata-vendosi-per-ish-zyrtaret-e-agjencise-se-akreditimit/>

Gani Bajraktari, profesor i rregullt, **Shpend Elezi**, profesor i asocuar **Afrim Poniku**, **Arlind Batalli**, **Dardan Koçinaj**, **Edmond Haliti** dhe **Xhevdet Krasniqi**, asistentë

Më 15 qershor 2016 Prokuroria Speciale ngriti aktakuzë kundër 64 personave për gjashtë vepra penale: keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, marrje e ryshfetit, dhënie e ryshfetit, trajtim i pandërgjegjshëm mjekësor, ushtrim i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore e farmaceutike dhe shmangie nga tatami.⁵⁷ Duke e pasur parasysh numrin e madh të të akuzuarve, Gjykata Themelore, për lehtësim të procesit gjyqësor, e ndau aktakuzën në tri raste: ‘Stenta 1’, ‘Stenta 2’ dhe ‘Stenta 3’. Gjashtë prej këtyre të akuzuarve janë staf akademik i Fakultetit të Mjeksësisë: Gani Bajraktari, profesor i rregullt, Shpend Elezi, profesor i asocuar, si dhe Afrim Poniku, Arlind Batalli, Dardan Koçinaj, Edmond Haliti dhe Xhevdet Krasniqi, asistentë⁵⁸. Portali kallxo.com kishte publikuar sms-të e mjekëve të dyshuar, nga të cilat shihej se si pacientët me probleme zemre i referonin nga QKUK-ja për në spitale private⁵⁹.

Deri më tani, në rastin ‘Stenta 1’ janë dënuar ish-ministri i Shëndetësisë, Ferid Agani, me dy vjet e gjashtë muaj burgim efektiv dhe ish-Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, Gani Shabani, me dy vjet burgim efektiv⁶⁰. Rasti ‘Stenta 2’ është ende në process, kurse rasti ‘Stenta 3’ është në fazën e konfirmimit të aktakuzës⁶¹.

57 «Konfirmohet Aktakuza edhe Ndaj 46 Mjekëve Të Akuzuar Në Rastin ‘Stenta’», Insajderi, 21 June 2018, gjendet në: insajderi.com/konfirmohet-aktakuza-edhe-ndaj-46-mjekeve-te-akuzuar-ne-rastin-stenta/

58 Arbër Kadriu «Apeli refuzon kundërshtimet e të akuzuarve në rastin ‘Stenta’», Kallxo, 17 gusht 2018, gjendet në: <https://kallxo.com/apeli-refuzon-kundershtimet-e-te-akuzuarve-ne-rastin-stenta/>

59 Paulina Nushi «I Akuzuari i ‘Stentave’ Kandidat Për Akademik», Kallxo, 26 nëntor 2016, gjendet në: <https://kallxo.com/i-akuzuari-i-stentave-kandidat-per-akademik/>

60 Lavdim Bajraktari «‘Stenta 2’, mjekët e akuzuar e quajnë aktakuzën ndaj tyre si të pabazuar në prova, kurse veprimet e tyre si të duhura», 1 prill 2019, gjendet në:

<https://betimiperdrejtesi.com/stenta-2-mjeket-e-akuzuar-e-quajne-aktakuzen-ndaj-tyre-si-te-pabazuar-ne-prova-kurse-veprimet-e-tyre-si-te-duhura/>

61 Po aty.

Më 20 maj 2018 Gjykata Themelore në Prishtinë shpalli aktvendimin për refuzimin e kërkesës së Gani Bajraktarit dhe të 38 të akuzuarve të tjerë në rastin 'Stenta 2' për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave. Gjykata e Apelit e refuzoi si të pabazuar ankesën e Gani Bajraktarit, duke e konfirmuar aktvendimin e Gjykatës Themelore për hedhjen e aktakuzës⁶².

Për këtë rast kërkuam prononcime nga profesorët Gani Bajraktari e Shpend Elezi, si dhe asistentët Afrim Poniku, Arlind Batalli, Dardan Koçinaj, Edmond Haliti dhe Xhevdet Krasniqi. Përgjigje morëm vetëm nga profesor Bajraktari, i cili na tha se qasja jonë për prezantimin e këtij rasti është diskriminuese e selektive dhe na dha komente jorelevante për raportin tonë.

62 «Konfirmohet Aktakuza Ndaj 46 Mjekëve Në Rastin 'Stenta'», 21 qershor 2018, gjendet në: www.koha.net/kronike/100622/konfirmohet-aktakuza-ndaj-46-mjekeve-ne-rastin-stenta/.

Më 11 nëntor 2016, Prokuroria Themelore në Prishtinë ngriti aktakuzë ndaj Murat Mehës, Kryeshef i Përgjithshëm i Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK), Ismet Kryeziut, Drejtor i Departamentit Ligjor në AKK, si dhe Nemanja Spasi -it, Shef i Zyrës Kadastrale në Komunën e Graçanicës, për keqpërdorimin e pozitës zyrtare apo autoritetit zyrtar⁶³.

Sipas aktakuzës, që nga 26 shtatori 2014 tre të pandehurit kishin keqpërdorur vazhdimisht detyrat zyrtare, meqë e pengonin palën e dëmtuar «Marigona Residence» prej ushtrimit të veprimtarisë, duke e vënë kështu në pozitë të pabarabartë në raport me ligjin e zbatueshëm sa i përket të drejtës së bartjes së pronësisë në regjistrin kadastral⁶⁴.

Sipas aktakuzës, të pandehurit Meha dhe Kryeziu kishin detyruar të pandehurin Nemanja Spasi të vepronte në bazë të një mendimi profesional, të nxjerrë nga Agjencioni Kadastral i Kosovës më 21 janar 2015, i cili në aktakuzë konsiderohet kundërligjshëm dhe i acenontepalës së dëmtuar ushtrimin e veprimtarisë ekonomike, duke i shkaktuar dëm të konsiderueshëm material. Pala e dëmtuar pretendonte dëm në vlerë prej 5 milionë eurosh⁶⁵.

Më 31 korrik 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë e hodhi poshtë aktakuzën për rastin në fjalë, konform Kodit të Procedurës Penale, duke e pushuar procedurën për këtë çështje⁶⁶. Prokuroria Themelore në Prishtinë parashitroi ankesë ndaj këtij aktvendimi⁶⁷. Më 23 tetor 2017 Gjykata e Apelit refuzoi ankesën e Prokurorisë Themelore, duke e vërtetuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë⁶⁸.

63 «Apeli Vërteton Hudhjen e Aktakuzës Për Kryeshefin e AKK-Së, Murat Meha», Betimi Për Drejtësi, Instituti i Kosovës Për Drejtësi (IKD), 23 tetor 2017, gjendet në: betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-hudhjen-e-aktakuzes-per-kryeshefin-e-akk-se-murat-meha/.

64 «Murat Meha akuzohet për keqpërdorim të pozitës zyrtare», Koha.net, 20 prill 2017, gjendet në: www.koha.net/arberi/13316/murat-meha-akuzohet-per-keqperdorim-te-pozites-zyrtare

65 «Murat Meha Del Para Gjykatës», INSAJDERI, 17 maj 2017, gjendet në: <https://insajderi.com/murat-meha-del-para-gjykatës/>

66 «Refuzohet ankesa e Prokurorisë në rastin e Murat Mehës dhe dy të akuzuarve për keqpërdorim të pozitës zyrtare», Koha.net, 23 tetor 2017, gjendet në: <https://www.koha.net/arberi/52717/refuzohet-ankesa-e-prokurorise-ne-rastin-e-murat-mehes-dhe-dy-te-akuzuarve-per-keqperdorim-te-pozites-zyrtare/>

67 <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-hudhjen-e-aktakuzes-per-kryeshefin-e-akk-se-murat-meha/>

68 «Apeli Vërteton Hudhjen e Aktakuzës Për Kryeshefin e AKK-Së, Murat Meha», Betimi Për Drejtësi, Instituti i Kosovës Për Drejtësi (IKD), 23 tetor 2017, gjendet në: <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-hudhjen-e-aktakuzes-per-kryeshefin-e-akk-se-murat-meha/>

Sipas komunikatës së Gjykatës së Apelit, në «veprimet e të pandehurve nuk konsumohen elementet e veprës penale për të cilën ata ngarkohen», ngaqë vepra keqpërdorim i pozitës zyrtare konsiderohet e kryer kur bëhet me qëllim të sjelljes së dobisë ose të shkakimit të dëmit ndaj personit tjetër. Nga arsyetimi i dhënë i bie se nuk ka prova që veprimet e tyre ta kenë bërë një gjë të tillë⁶⁹.

Për rastin në fjalë i kërkuam prononcim profesor Murat Mehës, i cili nuk komentoi lidhur me vendimet e Gjykatës Themelore dhe të Apelit, por sqaroi se gjatë kësaj kohe ka qenë në marrëdhënie të rregullt pune në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, kurse në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe të Arkitekturës ka mbajtur vetëm orët me honorar për semestër.

69 «Apeli Vërteton Hudhjen e Aktakuzës Për Kryeshefin e AKK-Së, Murat Meha», Betimi Për Drejtësi, Instituti i Kosovës Për Drejtësi (IKD), 23 tetor 2017, gjendet në: <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-hudhjen-e-aktakuzes-per-kryeshefin-e-akk-se-murat-meha/>

Më 6 prill 2018 PSRK-ja ngriti aktakuzë ndaj 11 personave me funksione të larta politike të përfshirë në rastin 'Pronto': Adem Grabovci, Zenun Pajaziti, Ilhami Gashi, Xhavit Dakaj, Fatmir Shurdhaj, Sadat Gashi, Ismet Neziraj, Rexhë Abazi, Nijazi Kryeziu, Arbenita Pajaziti dhe Besim Beqaj⁷⁰. Nga përgjimet e bëra në vitet 2011-2012 dyshohej se këta persona shfrytëzonin pushtetin e tyre për punësimin e njerëzve në pozita publike pa meritë. Sipas aktakuzës, të pandehurit akuzohen për veprën penale «shkelje e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës në bashkëkryerje, nga neni 193, paragrafi 4, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, prej të cilave disa prej veprave kanë mbetur në tentativë», që do të thotë se kanë keqpërdorur pozitat zyrtare dhe kanë bashkëpunuar për t'u dhënë përparësi dhe privilegje personave të caktuar⁷¹.

Më 4 shkurt 2019 të akuzuarit e rastit 'Pronto' kërkuan që aktakuza të hidhej poshtë, me pretendimin se ishte e pabazuar. Pas ngritjes së aktakuzës, Besim Beqaj deklaroi se ishte i bindur që nuk ka bërë shkelje ligjore a tejkallim të kompetencave dhe shtoi se ishte institucionalist dhe prandaj i bindur që institucionet e përgjegjshme profesionale do ta trajtonin rastin me hollësi, duke shtuar se ishte i gatshëm të sqaronte secilin veprim politik e ligjor⁷². Më 3 prill 2019 Gjykata Themelore në Prishtinë refuzoi kërkesën e mbrojtjes së të akuzuarve për hedhjen poshtë të aktakuzës në rastin 'Pronto'⁷³, pra vendosi t'i gjykonte për akuzat e ngritura nga PRKS.

Në lidhje me këtë rast ne kërkuam një prononcim nga profesor Besim Beqaj, por nuk morëm kurrfarë përgjigje prej tij.

70 «Prokuroria ka ngritur aktakuzë ndaj 11 personave të përfshirë në skandalin e përgjimeve 'Dosja e Shefave'», Insajderi, prill 2018, gjendet në: <https://insajderi.com/prokuroria-ka-ngritur-aktakuzen-ne-rastin-e-quajtur-pronto/>

71 «Ngrihet aktakuzë kundër Klanit 'Pronto'», Koha.net, prill 2018, gjendet në: www.koha.net/arberi/85521/ngrihet-aktakuzen-kunder-klanit-pronto/

72 «Deklaratë e Ministrisë pas aktakuzës në rastin 'Pronto'», 6 prill 2018, gjendet në: <https://kallxo.com/deklarate-e-ministrit-pas-aktakuzes-ne-rastin-pronto/>

73 Blerta Iberdemaj «Gjykata Vendosi Për Aktakuzën e Rastit 'Pronto'», KALLXO.com, prill 2019, gjendet në: <https://kallxo.com/gjykata-vendosi-per-aktakuzen-e-rastit-pronto/>

Në korrik 2016, Gazeta «Jeta në Kosovë»⁷⁴ raportoi se Shefi i Departamentit të Historisë në Fakultetin e Filozofisë, Selim Bezeraj, disertacionin e tij të doktoraturës⁷⁵ të mbrojtur në Universitetin e Tiranës më 2014, si dhe punimin shkencor «Soziale Lage in Albanien während der Regierung des Prinzen Wilhelm Wied nach Deutschen Reisenden», të dorëzuar për botim më 2015 në revistën akademike gjermane «Zeitschrift für Balkanologie», i ka kopjuar nga tema e magistraturës së z. Adam Christian, e mbrojtur në Universitetin e Vjenës më 2010⁷⁶.

Ish-rektori Ramadan Zejnullahu, në një letër zyrtare drejtuar Bezerajt pohonte se punimet i kishin rezultuar të njëjta pas krahasimeve, duke i cituar faqet identike, prandaj i kërkonte atij dhe dekanit të Fakultetit të Filozofisë, Bujar Dugollit, «s qarim të plotë me shkrim»⁷⁷. Në korrik 2016, Senati i UP-së e avancoi Bezerajn në pozitën Profesor Asistent në Departamentin e Historisë të Fakultetit të Filozofisë pa asnjë votë kundër. Më 11 janar 2018 Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim (ORCA) ngriti kallëzim penal ndaj Bezerajt për shkak të dyshimit se kishte kryer veprat penale cenimi i të drejtave të autorit dhe falsifikim i dokumenteve⁷⁸. Sipas kallëzimit penal, Bezeraj kishte konkurrar për t'u avancuar në pozitën Profesor Asistent në Fakultetin Filozofik me punimin shkencor të mësipërm, të cilin e kishte kopjuar nga punimi i masterit të z. Adam Christian për Universitetin e Vjenës⁷⁹. Kallëzimi penal e ngarkonte Bezerajn edhe për falsifikimin e dokumentit të revistës shkencore gjermane «Zeitschrift für Balkanologie» mbi botimin e punimit të vet në këtë revistë⁸⁰. Më 22 janar 2018, Bezeraj kishte deklaruar për gazetën e përditshme «Koha Ditore» se më 2016 është avancuar me punimin «Balkan Arastirmalari detgjisi» të botuar në Turqi, dhe jo me punimin që përmendte ORCA në kallëzimin penal⁸¹.

74 Rron Gjinovci «Shefi i Departamentit të Historisë dyshohet për plagjiaturë», 21 korrik 2016, gjendet në: <http://kallxo.com/gjnk/shefi->

75 Punimi i Doktoraturës së Selim Bezerajt «Shqiptarët dhe Austro-Hungaria gjatë viteve 1912-1914», gjendet në: <http://www.doktoratura.unitir.>

76 Punimi i Masterit të Adam Christian-it «Die Hesschaft des Prinzen zu Wied als Furst von Albanien unter besorenderer Berücksichtigung des ostereich-ungarischen diplomatischen Dienstes» gjendet në: <http://othes.univie.ac.at/>

77 Letra e Rektorit Ramadan Zejnullahu drejtuar profesorit Bezeraj dhe dekanit Dugolli, gjendet në:

<http://kallxo.com/gjnk/shefi-departamentite-historise-ne-dyshohet-per-plagjiature>

78 ORCA, Kallëzim Penal ndaj Selim Bezerajt për Prokurorinë Themelore në Prishtinë, 11 janar 2018.

79 Po aty.

80 Po aty.

81 Edona Kutleshi «Kallëzim penal ndaj profesorit të UP-së për plagjiaturë dhe falsifikim», Koha Ditore, 18 janar 2018.

Më 9 shkurt 2018 prokuroria ka kërkuar nga ORCA informacione për plotësimin e kallëzimit penal, të cilës kjo i ishte përgjigjur më 12 mars 2018⁸².

Prokuroria Themelore në Prishtinë i është përgjigjur kërkesës sonë për informata në lidhje me rastin në fjalë dhe ka konfirmuar se «pas analizimit të të gjitha të gjeturave, më 04.07.2018, prokurori i rastit e ka hedhë poshtë kallëzimin penal të lartcekur, pasi që nga provat e mbledhura është vërtetuar se nuk ekziston dyshimi i arsyeshëm se janë kryer veprat penale të lartcekura të parapara sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës».

Për rastin në fjalë i kërkuam prononcim Selim Bezerajt, i cili në përgjigjen e tij tha se institucionet kompetente kanë hedhur poshtë 'shpifjet' në fjalë dhe lëshoi akuza në adresë të organizatës sonë.

Duhet theksuar që pavarësisht se rasti i Bezerajt është raportuar nga mediat në vazhdimësi, se ORCA ka ngritë kallëzim penal, e se ADMOVERE ka publikuar përmbledhjen e raportimit të mediave ku shihet pjesa e punimit plagjiat dhe ka kërkuar publikisht nga Rektorati e Këshilli i Etikës së UP-së që të merren masa në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi, nuk kemi marrë përgjigje, as nuk jemi njoftuar nëse është ndërmarrë ndonjë veprim për këtë rast.

82 ORCA, Plotësim i Kallëzimit Penal ndaj Selim Bezerajt për Prokurorinë Themelore në Prishtinë, 12 mars 2018.

Në shkurt 2018, Valbona Berisha, profesoreshë asistente në Fakultetin e Edukimit, ngriti kallëzim penal ndaj Marjan Demës, Rektor i UP-së, Esat Kelmendit, Sekretar i Përgjithshëm i UP-së, Ethem Çekut, Dekan i Fakultetit të Edukimit, dhe Milaim Mazrekut, Sekretar i Fakultetit të Edukimit. Sipas kallëzimit penal të profesoreshës Valbona Berisha, Ethem Çeku dhe Milaim Mazreku akuzohen të kenë keqpërdorë pozitën zyrtare, kurse Marjan Dema dhe Esat Kelmendi të kenë heshtur duke mos i lajmëruar këto shkelje⁸³. Studentes së Fakultetit të Edukimit A.R. i mundësohej të mbronte temën e diplomës te profesoresha Myrvete Dreshaj-Baliu më 13 korrik 2017, ndonëse nuk e kishte përfunduar një provim te profesoresha Valbona Berisha në lëndën «Metodologjia e njohjes së nocioneve matematikore».

Këtë parregullsi e raportoi Valbona Berisha, duke deponuar deklaratë te Komisioni për Mbrojtje të Temave dhe te Sekretari i Fakultetit të Edukimit, Milaim Mazreku. Mbrojtja e dyshimtë e diplomës u anulua atë ditë, por nuk u morën masa të tjera për rastin në fjalë. Berisha prezantoi edhe dëshmi se dokumentacioni i studentes ishte i falsifikuar. Sipas kallëzimit penal, dekani Çeku dhe sekretari Mazreku kishin pasur ndikim që të mos merreshin masa, meqë në mbledhjen e shqyrtimit të rastit, sekretari Mazreku ka deklaruar se nuk e kishte fletëparaqitjen me vete, kurse dekani Çeku i ishte përgjigjur Valbona Berishës ishte se «nuk ka gjetje për ta dënuar studenten»⁸⁴.

83 Eros Klaiqi «Diplomimi i dyshimtë i studentes - profesoresha bën kallëzim penal ndaj Rektorit Dema e Dekanit Çeku», Insajderi, gusht 2018, gjendet në:

<https://insajderi.com/hulumtime/diplomimi-i-dyshimte-i-studentes-profesoresha-ben-kallezim-penal-ndaj-rektorit-dema-e-dekanit-cekut/?fbclid=IwAR1Qp6EXDYI8XI6dQq12kuwsrnRtupecXltiFG5bNVrrZ0Ba-RZoS5VqUc-8>

84 Kallëzim Penal për Prokurorinë Themelore – Departamenti për Krime të Rënda – Prishtinë nga profesoresha Valbonë Berisha, 23 shkurt 2018, ndaj Marjan Demës, Rektor i UP-së, Esat Kelmendit, Sekretar i Përgjithshëm i UP-së, Ethem Çeku, Dekan i Fakultetit të Edukimit, Milaim Mazrekut, Sekretar i Fakultetit të Edukimit.

Ne kërkuam një prononcim nga rektori Marjan Dema, i cili ndonëse na premtoi përgjigje, nuk na e dha asnjëherë. Kërkuam prononcim edhe nga dekani Ethem Çeku, por nuk morëm përgjigje as prej tij. Më pas kërkuam një prononcim edhe nga profesoresha Valbona Berisha, e cila na tha: «Nuk kam asnjë informatë në lidhje me përfundimin në rastin e studentes A.R. Asnjë masë disiplinore nuk është marrë ndaj saj. Nuk kam asnjë informacion, e as ftesë nga prokuroria e krimeve të rënda për kallëzimin penal të dorëzuar në shkurt 2018».

Pak para përfundimit të raportit, morëm një përgjigje nga Sekretari i Përgjithshëm i UP-së, Esat Kelmendi, të cilën po e botojmë të plotë:

«Ju njoftoj se lidhur me rastin në fjalë, më 12 janar 2018, i kam kthyer një përgjigje profesoreshës Valbona dhe atë me këtë përmbajtje:

‘Bazuar në ligjin për shërbimin civil, dyshimet tuaja për shkelje duhet t’i araqiten dekanit të njësisë akademike si udhëheqës i drejtpërdrejtë, nëse dekani konstaton se ka elemente për shkelje të rëndë disiplinore, ai është kompetent që rastin t’ia paraqesë Komisionit Disiplinor dhe pikërisht për këtë sot kam diskutuar me dekanin e fakultetit. Lënda do t’i procedohet dekanit për shqyrtim.’

Këtë çështje e kemi diskutuar edhe me rektorin, prandaj bashkarisht me të kemi kërkuar nga Dekani që ta trajtoj rastin në Këshill të Fakultetit dhe nëse Këshilli konstaton shkelje, atëherë dekani duhet të na referoj rastin për komision disiplinor.

Në bazë të informatave nga fakulteti, kjo lëndë më pas ishte shqyrtuar brenda Këshillit të Fakultetit. Gjithashtu kjo çështje është diskutuar edhe në Këshill Drejtues, respektivisht është ftuar dekani i Fakultetit që të sqaroj gjithë procesin e zhvilluar lidhur me rastin në fjalë. Këshilli Drejtues në këtë takim ka marr vendim për emërim të një komisioni prej 3 anëtarëve për të verifikuar pretendimet e profesoreshës në fjalë.

Komisioni ka hartuar një raport lidhur me rastin, të cilin më pas e ka miratuar Këshilli Drejtues.

P.S. Kjo përgjigje njëherësh është përgjigje edhe e Rektorit» -

PËRFUNDIME

PERFUNDIMET

Institucionet gjyqësore e prokuroriale nuk ofrojnë informacione për rastet kur pjesëtarët e stafit akademik të UP-së përballen me ligjin, që do të thotë se i mbajnë të fshehta dhe larg syrit të publikut. As nga ana e UP-së nuk ka gatishmëri për të ofruar informacione rreth përballjeve të stafit akademik të vet me ligjin. Për më tej, asnjë profesor nuk është suspenduar për shkak të përballjes me ligjin.

- Për t'i përmbledhur rastet kur të dyshuarit, të akuzuarit e të dënuarit janë pjesëtarë të stafit akademik të UP-së, kërkuam dokumente publike në shtatë gjykatat themelore të Kosovës, në Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Gjiilan e Gjakovë, si dhe kontaktuam Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK) e Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGjK). Tri nga shtatë gjykatat themelore – ajo në Pejë, në Prizren dhe Gjakovë – u përgjigjën se nuk kishin lëndë të pjesëtarëve të stafit akademik të UP-së në gjykatat e tyre, ndërkaq gjykatat në Ferizaj, Mitrovicë e Prishtinë, ndonëse u shprehën të gatshme të na ndihmonin, nuk iu përgjigjën asnjërës prej kërkesave tona. Mospërgjigjja e Gjykatës Themelore në Prishtinë na e afektoi raportin më së rëndi, duke qenë se lëndët e përballjeve me ligjin të profesorëve të UP-së gjenden kryesisht në këtë gjykatë. Njësoj, as KGjK e as KPK nuk iu përgjigjën kërkesave për të na siguruar qasje në dokumente publike. Duhet veçuar megjithatë Gjykata Themelore në Gjiilan, e cila iu përgjigj kërkesës sonë dhe ishte shumë bashkëpunuese.

- Për rrjedhojë, organizata vendosi t'i prezentonte kronologjikisht rastet e publikuara nëpër media gjatë kësaj dekade kur pjesëtarë të stafit të rregullt akademik të UP-së kanë rënë ndesh me ligjin, d.m.th. në gjykatat e Kosovës kanë pasë ose kanë kallëzime penale, aktakuza, dënime, etj.

1. Janë 8 aktakuza gjithsejt, në të cilat përfshihen gjithsej 15 pjesëtarë të stafit akademik të UP-së, si dhe 2 kallëzime penale, në të cilat përfshihen gjithsej 4 pjesëtarë të këtij stafi. Pra, sipas raportimeve në mediat kosovare, janë gjithsej 19 pjesëtarë të stafit akademik të UP-së të cilët kanë pasur dhe/ose kanë lëndë në gjykatat e Kosovës.

2. Nga 8 aktakuzat, 5 lidhen drejtpërdrejt me profesorë me pozita e funksione të larta publike si: Valton Beqiri, ish-Ministër i Kulturës; Enver Hasani, ish-Kryetar i Gjykatës Kushtetuese dhe ish-Rektori UP-së; Murat Meha, Kryeshef i Përgjithshëm i Agjencisë Kadastrale të Kosovës; Besim Beqaj, ish-Ministër i Zhvillimit Ekonomik; si dhe Ferdije Zhushi, ish-Kryetare e Bordit të Agjencisë së Akreditimit të Kosovës. Nga 8 aktakuzat, vetëm 2 lidhen me UP-në, kurse 6 të tjera me veprime jashtë UP-së. , Gjykata e Apelit ka hedhur poshtë 4 nga aktakuzat, 1 është parashkruar, kurse 3 janë ende në proces. Deri më sot nuk është dënuar asnjë profesor i UP-së me vendim të formës së prerë.

- Sipas hulumtimeve të organizatave të shoqërisë civile, rezulton se: një pjesë e madhe e pjesëtarëve të stafit akademik të UP-së nuk i justifikojnë titujt akademikë; plagjiatura ka përhapje shqetësuese si te stafi akademik, ashtu dhe te studentët; shumë profesorë nuk i mbajnë me rregull ligjëratat dhe provimet, për shkak të angazhimeve qoftë në poste publike qeveritare, qoftë në institucione të tjera të arsimit të lartë, duke ua ngarkuar këto detyrime asistentëve; ngacmimet seksuale, megjithëse të përhapura, pothuajse nuk raportohen fare, e as për rastet e pakta që raportohen, nuk ndërmerren masa.

-Askush nga Rektorati i UP-së, duke përfshi rektorin, prorektorët, Këshillin e Etikës dhe Sekretarin e Përgjithshëm të UP-së, nuk pranoi të intervistohet lidhur me rezultatin e shkeljeve të lartpërmendura nga pjesëtarë të stafit akademik të UP-së.

- Pesë prej dekanëve, konkretisht Lindita Sejdiu-Rugova nga Fakulteti i Filologjisë, Ethem Çeku nga Fakulteti i Edukimit, Enver Hamiti nga Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Musa Selimi nga Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit, si dhe Haxhi Gashi nga Fakulteti Juridik, nuk na i janë përgjigjur kërkesës për intervistë as përmes e-mail-it e as përmes telefonit.

- Katër prej dekanëve, konkretisht But Dedaj nga Fakulteti Ekonomik, Bujar Dugolli nga Fakulteti Filozofik, Tahir Arbnesi nga Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore, dhe Agim Selimi nga Fakulteti i Arteve, na thanë se Kolegjiumi i Dekanëve ka marrë vendim që dekanët individualë të mos u përgjigjen pyetjeve nga shoqëria civile dhe se ato duhet t'u drejtohen Sekretarit i Përgjithshëm të UP-së, i cili gjithashtu nuk na është përgjigjur.

- Dekani Abdullah Zejnullahu nga Fakulteti i Arkitekturës dhe i Ndërtimtarisë na ka pritur në takim dhe na ka informuar se nuk posedon të dhëna zyrtare për shkeljet në fjalë. Prodekania Gloria Staka, në emër të dekanes Suzana Manxhuka-Kërliu nga Fakulteti i Mjekësisë, premtoi se do t'u përgjigjej pyetjeve tona gjatë ditëve në vijim, por nuk na ka kthyer asnjë përgjigje deri në datën e publikimit të këtij raporti. Vetëm dy dekanë, Skënder Kaçiu nga Fakulteti i Bujqësisë dhe i Veterinarisë, si dhe Ahmet Shala nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, pranuan të zhvillonin intervistë dhe të dy u shprehën se nuk kishin asnjë rast të dokumentuar për shkeljet e lartpërmendura në fakultetet që drejtojnë.

SHTOJCĚ

5.

MOSOFRIMI I QASJES NË INFORMATA SI SHKELJE E LIRISË SË SHPREHJES

Rina Kika

Për qëllimet e përpilimit të këtij raporti, ADMOVEERE parashtroi një numër të madh kërkesash për qasje në dokumente publike në gjykata, prokurori, në KGjK, KPK, AKA dhe në UP. Kërkonim nga këto institucione publike të dhëna të sakta mbi mënyrën se si administrohen rastet nga sistemi i drejtësisë kur të dyshuarit, të akuzuarit e të dënuarit janë pjesëtarë të stafit akademik të UP-së dhe ç’masa ndërmerren nga UP-ja ndaj tyre për shkeljet. Shumica e institucioneve nuk na u përgjigjën fare ose nuk na i ofruan informatat e kërkuara.

Sipas Kushtetutës së Kosovës, secili person gëzon të drejtën e qasjes në dokumente publike⁸⁵. Procedura e qasjes në dokumente publike⁸⁶ fillon me paraqitjen e kërkesës për qasje, e cila i dorëzohet institucionit publik përkatës nga organizata ose qytetari i thjeshtë (në vazhdim «pala») ⁸⁷. Institucioni publik është i obliguar që brenda 7 (shtatë) ditëve prej kohës së regjistrimit të kërkesës të nxjerrë vendim për lejimin a refuzimin e plotë ose të pjesërishtë të qasjes në dokumente publike⁸⁸. Në rast të refuzimit të kërkesës, pala ka të drejtë të paraqesë kërkesë për rishqyrtimin e vendimit⁸⁹. Nëse institucioni publik nuk përgjigjet brenda afatit ligjor, atëherë sipas ligjit konsiderohet se ka dhënë përgjigje negative ndaj kërkesës⁹⁰.

85 Neni 41, paragrafi 1, Kushtetuta e Kosovës.

86 “Dokument publik” ose “dokument zyrtar” sipas nenit 3, paragrafi 1.3, të Ligjit Nr.03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike (“Ligji për Qasje në Dokumente Publike”) përfshin, por pa u kufizuar në to: «Të gjitha informatat e regjistruara në çfarëdo forme, të hartuara apo pranuar dhe mbajtura nga institucionet publike. Dokument zyrtar është çdo shkresë zyrtare që shërben për të dëshmuar ose për të vërtetuar diçka, pa marrë parasysh formën e saj fizike apo karakteristikat, tekstin e shkruar apo të shtypur, hartat, skemat, fotografitë, vizatimet, skicat, materialet punuese, si dhe incizimet tingullore, të zëshme, magnetike apo elektronike, incizimet optike apo video incizimet në çfarëdo lloj forme, si dhe pajisje bartëse për përpunim automatik të të dhënave me memorie të instaluar apo bartëse për arkivimin e të dhënave në formë digjitale».

87 Neni 4, paragrafi 1, Ligji për Qasje në Dokumente Publike.

88 Neni 7, paragrafi 8, Ligji për Qasje në Dokumente Publike.

89 Neni 7, paragrafi 9, Ligji për Qasje në Dokumente Publike.

90 Neni 10, Ligji për Qasje në Dokumente Publike.

Në rastin e ADMOVEVERE-s, kërkesat për qasje në dokumente publike janë dorëzuar te institucionet publike në përputhje me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike. Shumica e institucioneve nuk kanë kthyer përgjigje fare. Pasi mosofrimi i përgjigjes brenda afatit ligjor konsiderohet përgjigje negative, shtrohet pyetja: **kur kanë të drejtë institucionet publike ta refuzojnë qasjen në dokumente publike dhe a është vepruar drejt në rastin e kërkesave të ADMOVEVERE-s?**

Dokumentet që mbahen nga institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror janë në parim publike, mirëpo qasja ndaj tyre mund të kufizohet me ligj për shkak të privatësisë, sekreteve afariste ose informatave të klasifikuara të sigurisë⁹¹. Ligji për Qasje në Dokumente Publike i përcakton 11 arsye⁹² për të cilat institucionet publike mund ta kufizojnë të drejtën e qasjes në dokumente publike, ndër të cilat parashihet edhe kufizimi i qasjes për qëllim të «mbrojtjes së privatësisë dhe interesave të tjera legjitime private»⁹³. Sidoqoftë, i njëjti ligj parasheh se në rastet kur ekziston një «interes publik më i lartë» për ta shpalosur informatën e kërkuar, qasja në atë dokument duhet të sigurohet pavarësisht nga bazat për kufizimin e të drejtës për qasje në dokument publik⁹⁴. Sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pjesë e të «dhënave të ndjeshme personale» është edhe «çfarëdo përfshirje në ose heqje nga evidencat penale ose të kundërvajtjeve që ruhen në pajtim me ligjin»⁹⁵. Mirëpo, edhe në këtë ligj parashihet se të dhënat personale të ndjeshme mund të përpunohen⁹⁶ për arsye të «interesit thelbësor publik»⁹⁷. Këto dy ligje e parashohin publikimin e të dhënave në interes publik si përjashtim nga rregulla e përgjithshme e kufizimit të qasjes në dokumente publike për arsye të mbrojtjes së të dhënave personale të ndjeshme, por nuk e përkufizojnë termin «interes publik». Standardet për vlerësimin se cilat mund të konsiderohen çështje të interesit publik, në aspektin e qasjes në të dhëna dhe të publikimit të tyre, i gjejmë në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj). Meqë sipas nenit 53 të Kushtetutës së Kosovës, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në Kosovë interpretohen në harmoni me praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, në vazhdim janë shtjelluar disa nga standardet kryesore të vendosura nga kjo gjykatë, që trajtojnë çështjen e qasjes dhe të publikimit të të dhënave e të informatave në interes publik.

91 Neni 41, paragrafi 2, Kushtetuta e Kosovës.

92 Neni 12, paragrafi 1, Ligji për Qasje në Dokumente Publike.

93 Neni 12, paragrafi 1, pika 6, Ligji për Qasje në Dokumente Publike.

94 Neni 12, paragrafi 2, Ligji për Qasje në Dokumente Publike.

95 Neni 3, paragrafi 1. 25, Ligji Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

96 Sipas nenit 3, paragrafi 1.2, të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, përpunimi i të dhënave personale përfshin: «çdo veprim ose seri veprimesh që kryhen ndaj të dhënave personale me mjete automatike ose jo, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, tërheqja, konsultimi, përdorimi, publikimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarja ose ofrimi, njësimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose asgjësimi».

97 Neni 6, paragrafi 1.8, Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Liria e shprehjes dhe qasja në informata

Liria e shprehjes, sipas Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe sipas Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, përfshin të drejtën **për të kërkuar, për të pranuar dhe për të shpërndarë** informata dhe ide nëpërmjet mediave pa ndërhyrje⁹⁸. Këto dy marrëveshje ndërkombëtare bashkë me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) zbatohen drejtpërdrejt në Kosovë dhe mbizotërojnë ndaj të drejtës vendore në rast konflikti⁹⁹. Ndryshe nga Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, KEDNj nuk e përfshin shprehimisht të drejtën për të kërkuar informata në kuadër të të drejtës së lirisë së shprehjes. Neni 10 i KEDNj përcakton: «Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes¹⁰⁰. Kjo drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë **për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide** pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë».

Pavarësisht nga ky fakt, GjEDNj ka vlerësuar se në rrethana të caktuara mohimi i qasjes në informata mund ta shkaktojë cenimin e të drejtës së lirisë së shprehjes sipas KEDNj, edhe pse e drejta për të kërkuar informata publike nuk parashihet shprehimisht në kuadër të garantimit të lirisë së shprehjes¹⁰¹. Obligimi për ta interpretuar kërkesën për qasje në informata në kuadër të lirisë së shprehjes varet nga një numër kriteresh të përcaktuara nga GjEDNj. Katër kriteret kryesore për vlerësimin e rrethanave të rasteve individuale janë: a) qëllimi i kërkesës për informatë, b) natyra e informatës së kërkuar, c) roli i ankuesit, d) informata e qasshme dhe e gatshme¹⁰².

98 Neni 19, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Neni 19, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut.

99 Neni 22, paragrafi 1, 2 dhe paragrafi 3 i Kushtetutës së Kosovës.

100 Edhe KEDNj është e zbatueshme drejtpërdrejt në të drejtën pozitive të Kosovës sipas nenit 22, paragrafi 2 i Kushtetutës së Kosovës dhe mbizotëron ndaj të drejtës vendore në rast konflikti.

101 Magyar Helsinki Bizottság kundër Hungarisë, GjEDNj, Nr. 18030/11, 8 nëntor 2016, paragrafet 156 dhe referencat në to.

102 Magyar Helsinki Bizottság kundër Hungarisë, GjEDNj, Nr. 18030/11, 8 nëntor 2016, 158-169.

a) Qëllimi i kërkesës për informatë

Për t'u plotësuar ky kriter, qëllimi i kërkesës për qasje në informatë drejtuar autoritetit publik duhet të jetë që të mundësohet ushtrimi i të drejtës së lirisë së shprehjes për «të marrë dhe shpërndarë informata dhe ide» te të tjerët¹⁰³. GjEDNj ka theksuar se është e rëndësishme të përcaktohet a ka qenë «mbledhja e informatës hap i rëndësishëm përgatitor në ushtrimin e aktiviteteve gazetareske ose të aktiviteteve tjera që krijojnë një forum, apo që janë pjesë përbërëse esenciale për debat publik»¹⁰⁴. Kur një organizatë e shoqërisë civile e tërheq vëmendjen e publikut për çështje të interesit publik, ajo ushtron një «rol mbikëqyrës shoqëror»¹⁰⁵ me rëndësi të ngjashme me atë të mediave,¹⁰⁶ prandaj organizata e tillë gëzon mbrojtje të njëjtë me mediat, kur vlerësohet nëse qasja në informata për ushtrimin e lirisë së shprehjes ka qenë e nevojshme¹⁰⁷.

Në rastin e ADMOVERE-s, qasja dhe mbledhja e informatave në lidhje me përballjet me ligjin të pjesëtarëve të stafit akademik të UP-së ishte hap qenësor për hartimin e raportit «Profesorët përballë ligjit». Si pasojë e moslejimit të qasjes në informata, ADMOVERE u detyrua që raportin ta bazonte kryesisht në të dhënat nga burime dytësore të informatave, siç janë raportimet nëpër media dhe raportimet e organizatave të tjera të shoqërisë civile. Kjo nënkupton se raporti nuk arriti t'i paraqiste asnjë nga rastet e përplasjeve me ligjin të profesorëve, për të cilat nuk është raportuar nga mediat ose nga organizatat e shoqërisë civile. Për nevojat e mësipërme të ADMOVERE-s, qasja në informatat e kërkuara ishte hap i rëndësishëm përgatitor për ushtrimin e aktivitetit gazetaresk dhe paraqitjen e të dhënave në lidhje me administrimin e rasteve nga organet e drejtësisë.

103 Magyar Helsinki Bizottság kundër Hungarisë, GjEDNj, Nr. 18030/11, 8 nëntor 2016, paragrafi 158 dhe referencat në të.
104 Po aty.

105 Magyar Helsinki Bizottság kundër Hungarisë, GjEDNj, Nr. 18030/11, 8 nëntor 2016, paragrafet 159, 166 dhe referencat në to. Anglisht: «social watchdog».

106 Gra Stiftung Gegen Rassismus dhe 17 Antisemitismus kundër Zvicrës, GjEDNj, Nr. 18597/13, 9 janar 2018, paragrafi 57 dhe referencat në të.

107 Magyar Helsinki Bizottság kundër Hungarisë, GjEDNj, Nr. 18030/11, 8 nëntor 2016, paragrafi 159.

b) Natyra e informatës së kërkuar

Lidhur me kriterin e dytë të vlerësimit, GjEDNj ka theksuar se për t'u cilësuar moslejimi i qasjes si cenim i të drejtës së lirisë së shprehjes, natyra e informatave, e të dhënave dhe dokumenteve që kërkohen nga palët, duhet ta kalojë testin e interesit publik¹⁰⁸. Mes tjerash, Gjykata ka vlerësuar se informatë e natyrës së interesit publik mund të jetë ajo, shpalosja e të cilës rezulton me transparencë të shtuar “në mënyrën e udhëheqjes së punëve (marrëdhënieve) publike për çështje që janë të rëndësishme për publikun si tërësi dhe në këtë mënyrë e lejon pjesëmarrjen në qeverisje publike të publikut të gjerë»¹⁰⁹.

Qëllim kryesor i raportit «Profesorët përballë ligjit» është të ngjallë debat publik mbi mënyrën e administrimit të rasteve nga sistemi i drejtësisë kur të dyshuarit, të akuzuarit e të dënuarit janë profesorët e UP-së, si dhe mbi (mos)reagimet nga UP-ja dhe autoritetet tjerapublikendajrastevetëtilla. Njëraportmeinformatapërkëtoçështjedotë sillte transparencë të shtuar mbi mënyrën se si autoritetet publike i administrojnë dhe i trajtojnë rastet kur profesorët, që perceptohen si individë me status shoqëror më të lartë, përballen me ligjin.

Gjatë vlerësimit të testit të interesit publik, GjEDNj ka theksuar se «interesi publik nuk mund të reduktohet në etjen e publikut për informata të jetës private të të tjerëve, apo të dëshirës së publikut për sensacionalizëm». Po ashtu, gjatë vlerësimit të këtij testi, publikimi duhet të vështrohet në tërësi, bashkë me kontekstin në të cilin paraqitet¹¹⁰. Prandaj, **a mund të konsiderohet se ofrimi i qasjes në informata lidhur me profesorët që përballen me ligjin e cenon të drejtën e tyre për privatësi dhe mbrojtje të reputacionit?**

108 Magyar Helsinki Bizottag kundër Hungarisë, GjEDNj, Nr. 18030/11, 8 nëntor 2016, paragrafi 161.

109 Po aty.

110 Magyar Helsinki Bizottag kundër Hungarisë, GjEDNj, Nr. 18030/11, 8 nëntor 2016, paragrafi 162.

i) Interesi publik dhe mbrojtja e privatësisë

Sa i përket kontekstit të publikimit të raportit, është me rëndësi të theksohet se jo të gjitha informatat e kërkuara nga ADMOVEERE kishin të bënin me emrat e profesorëve që përballeshin me ligjin. ADMOVEERE kërkoi edhe informata statistikore mbi rastet e profesorëve, si për shembull, të dhëna se sa pjesëtarë të stafit akademik të UP-së janë hetuar, sa janë akuzuar, sa janë dënuar dhe çfarë ka ndodhur me lëndët e tyre, a janë parashkruar apo kanë pushuar hetimet, ose deri ku kanë shkuar ato. Pavarësisht kësaj, profesorët e përballur me ligjin do ta kishin shumë të vështirë të paraqisnin kundërgjegjësi bindëse mbi mbrojtjen e privatësisë dhe të reputacionit të tyre.

E drejta për mbrojtjen e reputacionit ofrohet në kuadër të nenit 8 të KEDNj dhe është pjesë e të drejtës në jetë private:¹¹¹ «'Jeta private' është term i gjerë që nuk ka përkufizim shterues dhe e mbulon integritetin fizik e psikologjik të një personi dhe mund të përfshijë aspekte të shumta të identitetit të personit»¹¹². Jeta private mbulon informatat personale për të cilat individët mund të kenë pritshmëri legjitime se nuk duhet të publikohen pa pëlqimin e tyre¹¹³. Në mënyrë që një person të mund të thirret në mbrojtjen e të drejtës së privatësisë sipas nenit 8 të KEDNj, sulmi ndaj reputacionit të atij personi duhet të arrijë një nivel të caktuar të seriozitetit, në mënyrë të tillë që e paragjykon gëzimin e të drejtës së tij/saj në jetë private¹¹⁴. Për më shumë, nuk mund të kërkohet mbrojtje e reputacionit, në qoftë se humbja e tij vjen nga veprimet e vetë personit, siç ndodh në raste kur ai/ajo e humb reputacionin për shkak të kryerjes së ndonjë veprë penale¹¹⁵. Rrjedhimisht, pjesëtarëve të stafit akademik të UP-së, të dënuar për kryerjen e veprave penale, nuk mund të konsiderohet se do t'u cenohej e drejta në jetë private në qoftë se të dhënat për rastin e tyre do të publikoheshin, pasi humbja e reputacionit të tyre vjen si pasojë e parashikueshme e veprimeve të tyre. Për këtë arsye, ata nuk mund të kenë pritshmëri legjitime se të dhënat e tilla nuk duhen publikuar pa pëlqimin e tyre.

111 GjEDNj, Axel Springer kundër Gjermanisë, paragrafi 83 dhe referencat në të.

112 GjEDNj Axel Springer kundër Gjermanisë, paragrafi 83 (përkthim jozyrtar).

113 Po aty.

114 Po aty.

115 GjEDNj, Axel Springer kundër Gjermanisë, paragrafi 83; GjEDNj Sidabras and Džiautas kundër Lituaniës, nr. 55480/00 dhe 59330/00, paragrafi 49.

Përveç kësaj, të gjitha seancat gjyqësore janë të hapura për publikun, përpos në raste kur me ligj parashihet ndryshe¹¹⁶. Në procedurën penale, seancat gjyqësore janë të mbyllura për publikun çdo herë në lëndët që përfshijnë persona të mitur.¹¹⁷ Ndërkaq, kur procedura penale zhvillohet ndaj personave madhorë, seancat janë gjithëherë publike, përveç në rastet kur gjykata merr vendim për përjashtimin e publikut¹¹⁸. Këtë vendim gjykata mund ta marrë vetëm në raste të caktuara si p.sh. për ta ruajtur fshehtësinë zyrtare, për t'i mbrojtur të dëmtuarit ose dëshmitarët, ose jetën personale a familjare të të akuzuarit, të të dëmtuarit ose të pjesëmarrësve të tjerë në procedurë¹¹⁹. Pra, gjykata duhet të marrë vendim për përjashtimin e publikut, përndryshe seancat gjyqësore janë të hapura dhe çdokush mund të marrë pjesë në proces gjyqësor dhe t'i dëgjojë të gjitha informatat në lidhje me rastet në shqyrtim dhe të informohet kush është palë në procedurë, pra t'ia dijë emrin dhe mbiemrin të pandehurit, akuzën që i ngarkohet, t'i dëgjojë dëshmitarët dhe provat e paraqitura, dhe në fund të jetë i pranishëm kur gjykata e shpall aktgjykimin për rastin përkatës.

116 Neni 7, paragrafi 4 Ligji 06/L – 054 për Gjykatat.

117 Neni 47, Kodi Nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur.

118 Neni 294, Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale.

119 Po aty.

ii) Mbrojtja e privatësisë sipas Udhëzimit Administrativ për anonimizimin dhe publikimin e aktgjykimeve përfundimtare

Sipas Udhëzimit Administrativ për anonimizimin dhe publikimin e aktgjykimeve përfundimtare, të nxjerrë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) në vitin 2016 (**Udhëzimi për anonimizimin e aktgjykimeve**), të dhënat personale të të gjitha vendimeve përfundimtare penale, civile, administrative e ekonomike duhen anonimizuar duke i hequr, mes tjerash, emrin dhe mbiemrin e palës, vendin e lindjes, emrin dhe mbiemrin e përfaqësuesve të palëve, të avokatëve, noterëve, emrat e ekspertëve, të dëshmitarëve, e me radhë. Ky udhëzim administrativ ende nuk është shfuqizuar nga KGJK dhe ka mundësi të paraqitet si argument nga gjykatat për mosofrimin e qasjes në vendimet gjyqësore. Baza kryesore ligjore për nxjerrjen e Udhëzimit për anonimizimin e aktgjykimeve është neni 2 i Ligjit Nr.05/L-032 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-199 për Gjykatat, të publikuar në Gazetën Zyrtare më 30 qershor 2015, ku përcaktohet si vijon:

«Neni 2 [te] Neni 6 i ligjit bazik, pas paragrafit 2, shtohet paragrafi i ri 3, me tekstin si në vijim: 3. Gjykatat publikojnë aktgjykimet e plotfuqishme në faqe të tyre zyrtare të internetit, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e arritjes së plotfuqishmërisë së aktgjykimit në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe rregullat e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Këshilli), **duke siguruar mbrojtjen e të dhënave personale.**»

Megjithatë, në nëntor 2018, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin Nr.06/L-054 për Gjykatat (**Ligji i ri për Gjykatat**), i cili hyri në fuqi më 2 janar 2019 dhe i shfuqizoi të dy ligjet e mëparshme. Ligji i ri për Gjykatat, te rregullimi i publikimit të vendimeve gjyqësore përcakton: «Gjykatat publikojnë të gjitha aktgjykimet në faqen e tyre zyrtare të internetit, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e nxjerrjes së aktgjykimit në pajtim me legjislacionin në fuqi. Këshilli nxjerr akte nënligjore për zbatimin e këtij neni.»¹²⁰

¹²⁰ Neni 6, paragrafi 3 Ligji i ri për Gjykatat.

Pra, Kuvendi i Kosovës ka vendosur qëllimisht ta heqë përcaktimin nga kjo dispozitë, i cili i jep KGJK-së kompetencën për të miratuar rregullore për nxjerrjen e aktgjykimeve **që kanë për qëllim të sigurojnë mbrojtjen e të dhënave personale**. Ky ndryshim në ligj mund të interpretohet si shprehje e qartë e vullnetit të ligjvënësit për ta kufizuar kompetencën e KGJK-së që të nxjerrë udhëzim administrativ për publikimin e aktgjykimeve. KGJK nuk mund ta mbështesë më Udhëzimin për anonimizim të aktgjykimeve në Ligjin e ri për Gjykatat. Prandaj, do të duhej ta shfuqizonte atë për shkak se baza kryesore ligjore mbi të cilën ai mbështetet është shfuqizuar nga Kuvendi i Kosovës. Madje, sipas Ligjit për Gjykatat, të gjitha aktgjykimet do të duhej të ishin publike në faqet zyrtare të internetit të gjykatave, gjë që do ta lehtësonte punën e mediave dhe të organizatave të shoqërisë civile, pasi informatat do të ishin të qasshme online dhe kësaj do të ishin të panevojshme kërkesat për qasje në dokumente publike për t'i siguruar vendimet gjyqësore. Rrjedhimisht, çdo argument që merr për bazë mbrojtjen e privatësisë sipas këtij udhëzimi administrativ, nuk mund të konsiderohet bindës apo i bazuar.

c) Roli i ankuesit

Ushtrimi i rolit mbikëqyrës shoqëror nga organizatat e shoqërisë civile që ngrenë çështje të interesit publik, i mvësh ato me mbrojtjen e njëjtë që e gëzojnë mediat sipas KEDNj-së¹²¹. GjEDNj ka vlerësuar se «mënyra në të cilën mbikëqyrësit shoqërorë i realizojnë aktivitetet e tyre ka ndikim të madh në funksionimin e mirëfilltë të një shoqërie demokratike»¹²².

Prandaj, «është në interes të shoqërisë demokratike të mundësojë që mediat ta ushtrjnë rolin jetik të 'mbikëqyrësit shoqëror' duke shpërndarë informata që janë në interes publik, ashtu siç është e rëndësishme edhe që organizatat e shoqërisë civile ta kryejnë rolin e tyre të raportimit për çështje në interes publik». Është e qartë se edhe ky kriter i vendosur nga GjEDNj është përmbushur në rastin e ADMOVERE-s, e cila si organizatë e shoqërisë civile ka për qëllim të informojë publikun dhe të gjenerojë debat publik në lidhje me administrimin e drejtësisë në rastet kur profesorët përballen me ligjin.

d) Informata të qasshme dhe të gatshme

Çështjet nëse informatat janë të qasshme dhe të gatshme apo duhet të mblidhen nga fillimi, si dhe nëse mbledhja e informatave paraqet vështirësi për shtetin, janë marrë parasysh nga GjEDNj gjatë vlerësimit se a është refuzuar qasja në kundërshtim me nenin 10 të KEDNj-së¹²³. Megjithatë, Gjykata nuk e ka pranuar si të bazuar pretendimin e autoriteteve shtetërore se ka qenë e vështirë të sigurohen informatat, në qoftë se vështirësia ka ardhur për faj të «vetë praktikave të atij autoriteti shtetëror»¹²⁴. Në procedurën penale, gjithmonë regjistrohet edhe profesioni i personit të akuzuar a të dyshuar për kryerjen e një vepre penale. Prandaj, mbledhja e të dhënave për profesorët e përballur me ligjin nuk do të duhej të paraqiste vështirësi.

121 Magyar Helsinki Bizottag kundër Hungarisë, GjEDNj, Nr.18030/11, 8 nëntor 2016, paragrafi 166 dhe referencat në të.

122 Po aty.

123 Magyar Helsinki Bizottag kundër Hungarisë, GjEDNj, Nr.18030/11, 8 nëntor 2016, paragrafi 169 dhe referencat në të.

124 Po aty.

ADMOVEVERE ka kërkuar qasje në informata në mënyrë që t'i përmbledhë ato në një raport, t'ia paraqesë publikut dhe të zhvillojë debat mbi trajtimin që autoritetet publike ua bëjnë shkeljeve të ligjit nga persona që gëzojnë status shoqëror më të lartë, siç janë profesorët e UP-së.

Paraqitja e informatave të plota e të sakta mbi administrimin e rasteve nga organet e drejtësisë kur të dyshuarit, të akuzuarit ose të dënuarit janë pjesëtarë të stafit akademik si dhe paraqitja e të dhënave mbi reagimet dhe masat e ndërmarra nga UP-ja dhe institucionet e tjera në raport me ta, është qenësore për zhvillimin e një debati publik të mirëfilltë lidhur me çështjen.

Si pasojë e moslejimit të qasjes në informata, ADMOEVERE e ka bazuar raportin kryesisht në të dhëna nga burime dytësore të informatave, siç janë raportimet nëpër media dhe raportimet e organizatave të shoqërisë civile. Përshkaktëkësaj, raporti përmban vetëm informata të dhënat e pjeseshme përshkaktë mospërgjigjes së autoriteteve publike. Mosofrimi i qasjes në informata e ka penguar ADMOEVERE-n prej ushtrimit të rolit mbikëqyrës shoqëror dhe zhvillimit të një debati të mirinformuar për një çështje të interesit publik. Prandaj mund të përfundojmë se autoritetet publike, të cilat nuk i kanë ofruar qasje në informata ADMOEVERE-s, ia kanë cenuar të drejtën e lirisë së shprehjes, përkatësisht të drejtën për të shpërndarë informata pa ndërhyrje të autoriteteve publike.

PËRFUNDIM

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

378.2(496.51)(047)

Profesorët përballë ligjit / hartuar nga Aulonë Memeti. –
Prishtinë : Admovere, 2019. – 43 f. ; 21 cm.

1.Memeti, Aulonë

ISBN 978-9951-8961-5-3

ISBN 978-9951-8961-5-3



9 789951 896153